VENDIM
Nr.536, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË DURRËS TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Durrës të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1840 (një mijë e tetëqind e dyzet).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Durrës
Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
25,55,56,26-29	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative	Në pronësi
118,121,125,126,128, 129,130	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
137-175,1817,1821,1822	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
176-215,1823,1824,1835, 1836-1839,1840	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1803, 1807,1809-1816	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
127,131,132,133,134,135, 136	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive	Në pronësi
733-736	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
216-219,226-238,240-732,1825-1831,1832-1834	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
737-806,814-821,828-869 870- 1059,1819,1820,1 147(vetëm pasuria 5/43)	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
822-827	Varrezat publike	Në pronësi

1060-1146,1147(pa pasurinë 5/43)-1281	Troje dhe hapësira	Në përdorim
1286,1289,1293-1295, 1374-1377,1378-1398	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB-ve)	Në pronësi
1290-1292, 1370-1373	Prona që përdoren në fushën e bujqesisë dhe ushqimit (tokë produktive)	Në përdorim